



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Pergjegjes Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Mirëmbajtjes

870
10.03.2026

Nr.	Prot	Date	Vjetor
			2026
Plani Vjetor 2026			
Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Mirëmbajtjes			

Drejtuar	Kryetari ERE
	Bordi ERE
	Sekretari Pergjithshem
	Keshillare ERE

Nr.	Emërtimi i veprimit	Shoqëritë / Institucioni	Përgjegjësia	Periudha	Bashkëpunimi me sektorë apo drejtori
1	Përditësimi i faqes zyrtare të internetit të institucionit përfshin realizimin e publikimeve dhe përditësimet në përputhje me kërkesat dhe nevojat institucionale, me qëllim sigurimin e transparencës dhe disponueshmërisë së informacionit të saktë, të plotë dhe në kohë, në përputhje me standardet dhe rregullat përkatëse	ERE	Pergjegjes Sektori/Specialist	Cdo Muaj	
2	Konfigurimi i printerave dhe serverit të printerit, menaxhimi i aksesit dhe optimizimi i përdorimit për përdoruesit fundorë Ky proces përfshin instalimin dhe konfigurimin e serverit të printimit, që mundëson ndarjen dhe menaxhimin qëndror të shërbimit të printimit në nivel riçeti. Përveç kësaj, përfshihet përcaktimi i politikave të aksesit për përdoruesit, duke siguruar kontroll të saktë mbi privilegjet e përdorimit, si dhe përshatja e parametrave për përdoruesit fundorë.	ERE	Pergjegjes Sektori/Specialist	Janar - Shkurt 2026	
3	Monitorimi dhe menaxhimi i printimeve, fotokopjeve dhe skanimeve, si dhe zgjidhja e probleme teknike. Ky task përfshin monitorimin e vazhdueshëm dhe dokumentimin e sasisë së printimeve dhe fotokopjeve të realizuara çdo muaj, si dhe trajtimin e çështjeve teknike që mund të shfaqen gjatë përdorimit të pajisjeve. Gjithashtu, përfshihet mbajtja e një komunikimi të rregullt dhe efektiv me kompaninë që ofron shërbimin e printimit, për të siguruar që çdo problematikë të adresohen në mënyrë të shpejtë dhe efektive.	ERE	Specialist	Cdo Muaj	

<p>4</p> <p>Monitorimi dhe mirëmbajtja e të internetit. Ky task përfshin mbikëqyrjen e vazhdueshme të performancës së rrjetit të internetit dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur problemet që mund të ndikojnë në funksionimin e tij. Qëllimi është të sigurohet një performancë optimale e rrjetit dhe të minimizohen ndërprerjet, duke garantuar një shërbim të qëndrueshëm dhe efikas për të gjithë përdoruesit.</p>	<p>ERE</p>	<p>Pergjegjes Sektorri/Specialist</p>	<p>Cdo Muaj</p>	
<p>5</p> <p>Auditimi i vazhdueshëm i infrastrukturës IT dhe Sigurisë kibernetike. Ky task përfshin realizimin e një auditimi të vazhdueshëm dhe sistematik të infrastrukturës IT dhe proceseve të sigurisë të institucionit. Qëllimi është të monitorohen dhe vlerësohen në kohë reale risqet, dobësitë dhe përputhshmëria e masave të sigurisë me standardet dhe kërkesat, për të siguruar mbrojtjen e infrastrukturës dhe Informacionit të institucionit nga kërcënimet e mundshme.</p>	<p>ERE</p>	<p>Pergjegjes Sektorri/Specialist</p>	<p>Cdo Muaj</p>	
<p>6</p> <p>Ndjekja e seancave dëgjimore dhe sesioneve Zoom të organizuara nga institucioni. Ky task përfshin monitorimin dhe ndjekjen e seancave dëgjimore dhe sesioneve Zoom që organizohen nga institucioni gjatë vitit. Qëllimi është të sigurohet që të gjitha sesionet e planifikuara të realizohen në mënyrë efektive, dhe që informatat dhe materialet e ndara gjatë këtyre seancave të jenë të dokumentuara dhe të aksesueshme për stafin dhe palët e interesuara (sipas rasisit)</p>	<p>ERE</p>	<p>Pergjegjes Sektorri/Specialist</p>	<p>Cdo Muaj</p>	
<p>7</p> <p>Ndjekja e workshop-eve, aktiviteteve apo trajnimeve, sipas rasisit, përgjatë vitit 2026 brenda apo jashtë vendit si dhe online. Ky task përfshin planifikimin, koordinimin dhe ndjekjen e workshop-eve, aktiviteteve dhe trajnimeve të ndryshme që do të organizohen gjatë vitit 2026, brenda dhe jashtë vendit, si dhe ato online.</p>	<p>ERE</p>	<p>Pergjegjes Sektorri/Specialist</p>	<p>Cdo Muaj</p>	
<p>8</p> <p>Raport përmbledhës mbi gjendjen e IT dhe sigurinë kibernetike, planifikimi për vitin e ardhshëm</p>	<p>ERE</p>	<p>Pergjegjes Sektorri/Specialist</p>	<p>Dhjetor 2026</p>	

9	Përgatitja e informacionit për Bordin mbi analizën e punëve për 3 muajorin e parë, të dytë, të tretë dhe të katërt të vitit 2026 nga Sektori i Sigurisë Kibernetike & IT në zbatim të Rregullores së Brendshme të Entit Rregullator të Energjisë.	ERE	Pergjegjes Sektori/Specialist	Cdo 3 Muaj	
10	Trajtime për stafin mbi phishing dhe sigurinë e informacionit. Ky task përfshin organizimin dhe realizimin e trajnimeve të vazhdueshme për stafin mbi parandalimin e sulmeve të phishing-ut dhe praktikat më të mira për sigurinë e informacionit. Qëllimi është të rritet ndërgjegjësia dhe vëllencia e stafit ndaj kërcënimeve kibernetike, duke siguruar që ata të jenë gjithmonë të përgatitur dhe të aftë për të identifikuar dhe shmangur rreziqet që mund të ndikojnë në sigurinë e të dhënave dhe sistemeve të institucionit.	ERE	Pergjegjes Sektori/Specialist	Cdo Muaj	
11	Ngritja dhe mirëmbajtja e një sistemi backup/rezerve për sisteme informacionet e rëndësishme. Ky task ka për qëllim ngritjen dhe mirëmbajtjen e një sistemi backup/rezerve të besueshëm dhe efikas për ruajtjen e informacionit të rëndësishëm të institucionit. Procesi përfshin identifikimin e të dhënave kritike, zgjedhjen e infrastrukturës më të përshtatshme, instalimin dhe konfigurimin e softuerëve të nevojshëm, automatizimin e proceseve të backup-it, sigurimin e të dhënave përmes enkriptimit dhe kontrolleve të qasjes, si dhe testimin e rrikthimit të të dhënave për të siguruar që sistemi është në gjendje të riprohojë informacionin në rast nevojë. Gjithashtu, procesi përfshin dokumentimin e plotë të procedurave dhe monitorimin e vazhdueshëm të sistemit gjatë gjithë vitit.	ERE	Pergjegjes Sektori/Specialist	Janar - Qershor 2026	
12	Trajtimi dhe certifikimi i stafit IT për sigurimin e efikasitetit dhe sigurisë së infrastrukturës IT dhe rrjetit. Ky task ka për qëllim përmirësimin e aftësiave dhe njohurive të stafit IT përmes trajnimeve dhe marrjes së certifikimeve profesionale, në mënyrë që ata të mbajnë hapin me zhvillimet më të fundit teknologjike dhe të sigurojnë menaxhimin efikas të infrastrukturës IT të institucionit.	ERE	Pergjegjes Sektori/Specialist	Cdo Muaj	

<p>13</p> <p>Support per problemet me PC, konfigurimet e email-it dhe softueret per te gjithë punonjesit: Ky task përfshin ofrimin e mbështetjes teknike për punonjësit e institucionit në lidhje me problemet e mundshme të kompjuterëve, konfigurimin e llogarive të email-it dhe instalimin e softuerëve të nevojshëm për të siguruar që të gjithë përdoruesit të kenë akses në mjetet dhe resurset e nevojshme për realizimin e detyrave të tyre profesionale. Synimi është të sigurohet që infrastruktura IT të mbetet funksionale dhe e përshtatshme për nevojat e përditshme të stafit.</p>		<p>ERE</p> <p>Pergjegjes Sektorit/Specialist</p>	<p>Cdo Muaj</p>	
<p>14</p> <p>Implementimi i një antivirusi dhe EDR për mbrojtjen e serverëve dhe pajisjeve të punonjësve, me qëllim sigurimin e një mbrojtjeje të plote dhe të vazhdueshme ndaj kërcënimeve kibernetike, përmes detektimit proaktiv dhe reagimit të shpejtë ndaj incidenteve të sigurisë. Ky proces ka si qëllim rritjen e sigurisë kibernetike të institucionit duke implementuar një zgjidhje të integruar antivirusi dhe EDR, që mundëson monitorimin dhe mbrojtjen në kohë reale të serverave dhe pajisjeve të punonjësve. Me këtë zgjidhje, mund të parandalohet, zbulohet dhe reagohet shpejt ndaj kërcënimeve të mundshme, duke minimizuar rrezikun për humbje të të dhënave ose ndërprerje të shërbimeve.</p>		<p>ERE</p> <p>Pergjegjes Sektorit/Specialist</p>	<p>Cdo Muaj</p>	
<p>15</p> <p>Përgatitja e Raportit Vjetor mbi Gjendjen e Sigurisë Kibernetike për Operatorët e Infrastrukturrave Kritike për Vitin 2025 (Sektori i Sigurisë Kibernetike & IT). Ky task përfshin përgatitjen e raportit vjetor të sigurisë kibernetike për vitin 2025, që do të ofrojë një analizë të detajuar të gjendjes aktuale të sigurisë kibernetike për operatorët e infrastrukturave kritike. Raporti do të përmbledhë aspekte kyçe të sigurisë kibernetike si menaxhimi i rrezeve, mbrojtja e të dhënave, veprimet parandaluese dhe detajet e incidenteve të sigurisë të ndodhur gjatë vitit. Pjesë e këtij task-u është gjithashtu ofrimi i suportit për përgatitjen e raportit për publikim.</p>		<p>ERE</p> <p>Pergjegjes Sektorit/Specialist</p>	<p>Shkurt - Mars 2026</p>	
<p>16</p> <p>Ndjekja e suportit për operatorët në Platformën PCT dhe REMIT. Ofrimi i mbështetjes teknike për operatorët gjatë regjistrimit dhe përdorimit të platformës PCT, duke siguruar që procesi i ngarkimit të ofertave të jetë i qartë dhe i saktë.</p>		<p>ERE</p> <p>Pergjegjes Sektorit/Specialist</p>	<p>Cdo Muaj</p>	

<p>17 Ofrimi i mbështetjes teknike dhe keshillimit për platformën e Ankesave të Konsumatorëve (2026). Ky task përfshin ofrimin e mbështetjes teknike dhe keshillimit për Platformën e Ankesave të Konsumatorëve.</p>	<p>ERE</p>	<p>Pergjegjes Sektorri/Specialist</p>	<p>Gjate Vitit 2026</p>	
<p>18 Mbështetje logjistike dhe mirëmbajtje e ambienteve të zyrave Verifikimi i funksionimit të pajisjeve dhe infrastrukturës mbështetëse për të siguruar kushte të përshtatshme pune për stafin. Ndërhyrje dhe koordinim për zgjidhjen e problematikave teknike dhe logjistike në ambientet e institucionit.</p>	<p>ERE</p>	<p>Pergjegjes Sektorri/Specialist</p>	<p>Gjate Vitit 2026</p>	

Punoi:

Sh. Bajrami

PërgjegjësSektor i Teknologjisë
së Informacionit dhe
Mirëmbajtjes

Pranoi:

E. B. Radheshi

Sekretar Përgjithshëm